



Lidhja Demokratike e Kosovës

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2016 - 31 Dhjetor 2016

Përmbajtja:

<u>Raport i auditorëve të Pavarur.....</u>	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	6-14

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se Lidhjes Demokratike te Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “LDK”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2016, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2016, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 ,Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç paraqitet në shënimin 9 të pasqyrave financiare, Shpenzimet, subjekti politik ka Pagat dhe kompensimet ne vlerë 200,308.26 EUR, ne mungese te dokumenteve mbështetëse, kontratave te punës, vendimet etj, ne duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit nuk ishim ne gjendje të përfitojmë një siguri të arsyeshme në lidhje me plotësinë e kësaj shume për periudhën e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve te kontabilitetit te aplikueshme ne Kosove.
- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 EUR brenda një dite ne kundërshtim me kërkesat ligjore te Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit te terrorizmit, neni 26 Detyrimet shitesë të partive politike.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë

raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.pk

Fadil Hyseni
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	25,632.31	63,650.85
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		25,632.31	63,650.85
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	3	0.00	0.00
Parapagimet			46.64
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	1,046,616.03	573,898.53
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		1,046,616.03	573,945.17
Total pasuritë		1,072,248.34	637,596.02
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		566,946.61	45,900.01
Suficiti / (deficiti) i vitit		471,449.86	521,046.60
Total Ekuiteti		1,038,396.47	566,946.61
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		25,632.31	63,650.85
Gjithsej detyrimet afatgjata		25,632.31	63,650.85
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	5	5,979.88	6,998.56
Detyrimet tjera afatshkurtra	6	2,239.68	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		8,219.56	6,998.56
Gjithsej detyrimet		33,851.87	70,649.41
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		1,072,248.34	637,596.02

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2016	2015
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		942,522.00	945,000.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	7	0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	8		1,800.00
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	2	27,006.54	29,558.81
Të hyrat tjera		17,337.00	2,125.00
Gjithsej të hyrat për vitin		986,865.54	978,483.81
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	9	200,308.26	220,130.49
Shpenzimet e transportit	9	35,874.12	37,734.67
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	9	111,240.12	63,676.28
Shpenzimet e fushatës	9	22,036.50	1,966.60
Blerja e mallrave	9	4,483.02	5,119.55
Shpenzimet e përgjithshme	9	92,403.55	115,252.47
Shpenzimet e ndryshme	9	49,070.11	13,557.15
Gjithsej shpenzimet për vitin		515,415.68	457,437.21
Suficiti (deficiti) për vitin		471,449.86	521,046.60

1. Informata te përgjithshme

Lidhja Demokratike e Kosovës është partia e tretë më e madhe në Kosovë. Është një parti konservatore dhe liberale konservatore

Udhëheqja: Isa Mustafa (Kryetar i partisë)

Themelues: Ibrahim Rugova

Themeluar: 23 dhjetor 1989

Ideologjia: konservatizmi, neoliberalizmi, liberalizmi i tregut.

Pozita politike: Politika e qendrës së djathtë

Pasqyrat financiare te Lidhjes Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën NLB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////		0.00
Objektet					0.00
Veturat	63,460.00		31,730.00	12,692.00	19,038.00
Pajisjet e zyrës	25,393.32		15,235.99	7,618.00	2,539.33
Pajisjet e teknologjisë informative	19,363.80	798.00	11,618.28	6,048.54	2,494.98
Pajisjet tjera	1,320.00	1,680.00	792.00	648.00	1,560.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	109,537.12	2,478.00	59,376.27	27,006.54	25,632.31

Shënimi 4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Paraja në bankë	1,046,616.03	573,898.53
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	1,046,616.03	573,898.53

Shënimi 5. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Furnitor vendor	5,979.88	6,998.56
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	5,979.88	6,998.56

Shënimi 6. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2016 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	2,239.68	-
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	2,239.68	-

Shënimi 7: Donacionet dhe kontributet në të holla

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka pranuar donacione dhe kontribute në të holla gjatë vitit 2016.

Shënimi 8: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka pranuar kontribute në natyrë në mall dhe shërbime gjatë vitit 2016.

Shënimi 9: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	173,278.53	173,278.53	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	8,873.30	8,076.47	796.83
Kontributet pensionale të punëdhënësit	8,873.30	8,076.47	796.83
Tatimet në të ardhura personale	9,283.13	8,637.11	646.02
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	200,308.26	198,068.58	2,239.68
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	1,500.00	1,500.00	0.00
Karburantet	21,025.04	19,041.57	1,983.47
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	4,389.00	4,389.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajta e veturave	8,107.08	8,044.08	63.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	853.00	853.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	35,874.12	33,827.65	2,046.47

Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	25,760.66	25,760.66	0.00
Ushqimi	50,947.13	50,947.13	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	1,138.00	1,138.00	0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	12,730.00	12,470.00	260.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	20,664.33	20,664.33	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	111,240.12	110,980.12	260.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	22,036.50	20,372.50	1,664.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	22,036.50	20,372.50	1,664.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	4,483.02	4,483.02	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	4,483.02	4,483.02	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	55,099.90	55,099.90	0.00

Lidhja Demokratike e Kosoves

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2016 deri më 31 Dhjetor, 2016

Telefoni, interneti dhe posta	5,302.16	5,263.80	38.36
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	4,994.95	4,994.95	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	27,006.54	//////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		//////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	92,403.55	65,358.65	38.36
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	4,995.42	4,995.42	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	44,074.69	30,569.69	13,505.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	49,070.11	35,565.11	13,505.00
Gjithsej shpenzimet			
	515,415.68	468,655.63	19,753.51

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

	Paguar ndaj:				Vlera
Qëllimi i pagesës	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal	Data kur është bërë pagesa	në euro
Konferenca/tubime	Emerald Hotel	Prishtine	600015376	Specifikacioni	17,330.50
Shërbime mediale	Global Mission	Podujeve	601195755	01.04.2016	11,550.00
Material reklamues	Av. Albana Kelmendi (per Kashi)	Prishtine	1019683920	14.08.2016	20,000.00
Konferenca/tubime	KD Events	Prishtine	600602173	Specifikacioni	52,862.20
Ushqim dhe pije	Lesna Trade	Prishtine	600348561	Specifikacioni	6,040.87
Derivate	Petrol-Oti-Slovenija	Prishtine	600112370	Specifikacioni	20,747.45
Ushqim dhe pije	Sokoli e Mirusha	Prishtine	600236550	Specifikacioni	5,091.10
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					133,622.12